

Në Kodrën e Minatorëve në veri të Mitrovicës, vazhdojnë të ndihen të pasigurt banorët shqiptarë.

Mjetet e transportit u mungojnë, gjë që shton edhe më shumë pasigurinë teksa udhëtojnë drejt jugut. Biçikleta është mjeti i transportit për Jahir Demakun, i cili banon në Kodër të Minatorëve të veriut të Mitrovicës, sa herë që shkon në lagjen e tij. Ai nuk ankohet për lodhje. Sepse, halli i tij është rreziku që i kanoset sa herë që i bie qendrës së qytetit të banuar me serbë. Thotë se shpeshherë ka pasur provokime të shumta nga ta.

Jetesën në këtë lagje të thellë të veriut e rëndon edhe më shumë fakti se në mungesë sigurie gjatë transportit, të rinjtë e kësaj zone nuk po arrijnë as që të gjejnë punë me orar të përshtatshëm. Brahim Ferati thotë se momentet më të vështira janë ato të sëmundjeve. Për bashkëjetesën në këtë lagje, serbët nuk pranuan të flasnin për kamerën e RTK-së, ndërsa prapa saj thonë se edhe ata ndihen të frikësuar nga grupe të ndryshme. Këta banorë pohojnë se këtu afër jetojnë 57 familje shqiptare, përfshirë edhe komunitetet tjera, me rreth 80 shtëpi.